



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary


DATË/A:	24.02.2025
REFERENC-Ë:	24/5869/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Vita" Sh.p.k. Doganaj, Kaçanik Ekspluatim të gurit gëlqeror, Vranjak, Kaçanik.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore të operatorit, "Vita" Sh.p.k., Kaçanik, për veprimtarinë: Ekspluatim të gurit gëlqeror, Vranjak, Kaçanik.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/5869/MMPHI
Datë: 24.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit, "Vita" Sh.p.k. me nr. prot. 24/5869/MMPHI, i ndërpritet procedura administrative për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: Eksploatim të gurit gëlqeror, në ngastrën, nr. 1837/1, zona kadastrale, Vranjak, Kaçanik.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Vita" Sh.p.k. me nr. prot. 24/5869/MMPHI, Doganaj, Kaçanik me nr. prot. 24/5484/MMPHI, për veprimtarinë Eksploatim të gurit gëlqeror, Vranjak, Kaçanik, MMPHI konstaton që operatori **nuk ka plotësuar** kushtet administrative për vazhdim të Lejes Mjedisore.



Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Leje Mjedisore me nr.19/3151/ZSP/473/19 të datës: 03.10.2019;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:


- Licencën për shfrytëzim të gurit gëlqeror nga KPMM.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërprenë procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Kaçanik;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.